

ANILA OMARI

PËRHAPJA RAJONALE E SLLAVIZMAVE TË SHQIPES DHE VENDI I TYRE NË LEKSIKUN E SHQIPES STANDARDE

Huazimet sllave të shqipes kanë një veçori specifike në krahasim me huazimet nga gjuhët e tjera, që lidhet me shpërndarjen e tyre gjeografike. Huazimet nga gjuhët e perandorive të mëdha pushtuese me kohëzgjatje të rëndësishme, si latinishtja e turqishtja, kanë një shtrirje përgjithësisht mbarëgjuhësore. Huazimet nga italishtja janë kryesisht të karakterit dituror të hyra nëpërmjet kontakteve kulturore ose kanë një përhapje sipas shtresave sociale. Ndryshe nga këto, sllavizmat e shqipes paraqiten në përgjithësi të shpërndara në mënyrë lokale, kanë një përhapje të kufizuar dialektore, ndërsa vetëm një pjesë relativisht e vogël është bërë pronë e mbarë gjuhës. Kjo specifikë ka të bëjë domosdoshmërisht edhe me prejardhjen e huazimeve sipas përkatësisë dialektore-gjuhësore brenda grupit të gjuhëve sllave jugore, në përputhje me grupet gjuhësore sllave që pushtuan hapësirat e banuara nga shqiptarët në Ballkan: grupi i sllavishteve perëndimore në Veri dhe grupi i sllavishteve lindore në Lindje dhe Jug. Sipas kësaj përkatësie gjuhësore sllave, sllavizmat e të folmeve veriore të shqipes vijnë prej serbishtes/kroatishtes, ndërsa ato të të folmeve të Jugut vijnë prej bullgarishtes, përkatësisht maqedonishtes. Arsyet e kësaj shpërndarjeje gjeografike të sllavizmave të shqipes janë vetë rrethanat e ardhjes së sllavëve në Shqipëri, në formë valësh të njëpasnjëshme dhe nga drejtime të ndryshme, dhe me mënyrën e ngulimit të tyre në formë enklavash, në zona të caktuara, por kryesisht në zonat kufitare, ku kontaktet me popullsinë sllave kanë qenë të vazhdueshme për shekuj me radhë.

Hulumtimi në terren i sllavizmave të Shqipërisë veriore me konfigurimin e përhapjes gjeografike të leksemave prej nesh në vitin 1989¹ dhe i sllavizmave të Shqipërisë së mesme e jugore nga Xhelal Ylli në vitin 1987² nxjerr në pah

¹ Shih A. Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, QSA, IGJL, Botimet albanologjike, Tiranë, 2012.

² Shih Xh. Ylli, "Mbi disa huazime leksikore sllave në të folmet juglindore të shqipes", *Studime filologjike*, 1988/2, f. 151; Po ai, *Das slavische Lehngut im Albanischen, 1. Teil Lehnwörter*, Slavistische Beiträge 350, München, 1997.

karakterin përgjithësisht krahinor e nganjëherë tepër të ngushtë lokal të huazimeve nga serbishtja.

Nga një krahasim i të dhënave të mbledhura në terren në pika të veçanta përfaqësuese të krahinave të caktuara etnografike të Shqipërisë veriore, vihet re se të folmet e zonave kufitare të Veriut janë shumë më të pasura me sllavizma sesa ato të brendësisë. Përfundimet statistikore të dala nga kërkimet në terren na paraqiten për çdo pikë si më poshtë: në pikën 1 (Dajç – Breg i Bunës) gjëllijnë rreth 180 sllavizma, në pikën 2 (Malësi e Madhe) rreth 215, në pikën 3 (Barbullush – Gropa e Shkodrës) rreth 160, në pikën 4 (Prekal - Dukagjin) rreth 160, në pikën 5 (Bajzë – Rranzat e Mbishkodrës) rreth 190, në pikën 6 (Valbonë – Malësi e Gjakovës/Tropojës) rreth 280, në pikën 7 (Gjadër – Fushë Zadrinë) rreth 160, në pikat 8 e 9 (Kashnjet – Mirditë e Kallmet – Lezhë) rreth 130, në pikën 10 (Mërtur i Gurit – Pukë) rreth 210, në pikën 11 (Shupal - malësi e Tiranës) rreth 130. Kështu numrin më të madh të sllavizmave e ka e folmja e Valbonës, me një numër prej rreth 280 sllavizmash, zonë e cila ka pasur marrëdhënie tradicionale me Vuthajt matanë kufirit. Në Valbonë përdoren mjaft sllavizma me ngjyrim tepër lokal që nuk na kanë dalë në pika të tjera të Veriut, si: *cedillë, çeberr, qurë, gomile, gerbë, guskë, hejdhë, izëm, jezer, kalenicë, pojat, pudar, rasoj, raznicë, stenicë, teslicë, tug, tufat, vidër, volisht, voshtinë, voz, vrah, vredit, vrellë, zastojë, zavrak*.

Të së njëjtës natyrë me sllavizmat e Tropojës janë edhe ato të Pukës (pika 10 Mërtur i Gurit), si të folme që bëjnë pjesë të të njëjtin grup të gegërishtes verilindore.

Edhe në Malësi të Madhe, ku kontaktet me fqinjët sllavë kanë qenë të vazhdueshme, del një numër relativisht i madh sllavizmash periferikë, gjithsej rreth 215, të cilat në një pjesë të madhe hasen edhe më në jug, në Bajzë, Shkodër, Breg të Bunës e më poshtë si zona që u përkasin të folmeve të gegërishtes veriperëndimore.

Kështu, vihet re njëfarë ndarjeje e sllavizmave të Shqipërisë Veriore në dy grupe, sipas të folmeve ku bëjnë pjesë: sllavizma karakteristike për të folmet e gegërishtes veriperëndimore dhe sllavizma karakteristike për të folmet e gegërishtes verilindore. Kjo lidhet me marrëdhëniet që kanë pasur tradicionalisht krahinat e Veriut: Malësia e Madhe me fiset e Malit të Zi, ndërsa Malësia e Gjakovës e më tej Kosova me popullsinë serbe në kontakt.

Numri i sllavizmave vjen duke u pakësuar sa më drejt jugut e brendësisë që të zbresim, derisa në zonat e Lezhës (Kallmet), Mirditës (Kashnjet) e Malësisë së Tiranës (Shupal) reduktohet në rreth 130. Në këto zona përdoren më shumë fjalë vendi ose me prejardhje latino-romane në vend të fjalëve sllave, p.sh.: *afrohem për avitem* (Kallmet), *gjeth dale për babanik* (Kashnjet), *i pasur për i begatë; blozë, lbozë, therr* në vend të *çagjë; thark, dollap* në vend të *çarranik, zhele për crule* (Kallmet), *gërhas për dihas* (Kallmet), *ndreq* në vend të *godis* (Kashnjet), *rrashqel* në vend të *grabujë* (Kashnjet), *dash* për *ogic*,

shpat (qilimi) në vend të *polë* (Kallmet), *mif* në vend të *prashis*, *zhurmë* për *potere*, *kris* në vend të *trokas*, *shtat* në vend të *trup*, *ujit* në vend të *vadit*, *trinë* (*trenë*, *trenoçjë*) për *vllaçë* “lesë” etj.

Nga vëzhgimet tona në terren dhe nga bisedat me subjektet e kontaktuar rezulton se një numër sllavizmash në të folmet e Shqipërisë Qendrore janë të reja, të hyra në kohët e vona nëpërmjet gjuhës letrare. Këto fjalë pjesërisht kanë zëvendësuar, pjesërisht ekzistojnë paralelisht me fjalë të vjetra vendi a me prejardhje turke që përdoren më fort nga brezi i vjetër. P.sh. *bisedë* si fjalë në origjinë e gegërishtes veriore, në Malësinë e Tiranës dhe në zonat e tjera të brendësisë si Krujë e Mat njihet si e re, ndërsa i përgjithshëm dhe i vjetër aty është turqizmi *muhabet*; *bravë*, si fjalë e toskërishtes dhe e gjuhës letrare, është shtrirë edhe më në veri dhe pjesërisht ka zëvendësuar fjalët më të vjetra krahinore: *çivi*, *çark*, *lloz*, *drang*, *llokmë*, duke shënuar njëkohësisht edhe një kuptim të ri modern të mjetit për mbylljen e derës; fjala *buças/ buçet* është e re, më të përdorura janë vendaset *gjëmon*, *ushton*; fjala *krasit* njihet si e gjuhës letrare por nuk ka mundur të zëvendësojë vendasen *kî*; leksema e gjuhës letrare me burim gego-verior *kreshnik* njihet, por në përdorim është *trim*; fjala me prejardhje sllave *stol* nuk ka arritur të zëvendësojë vendasen *shkam*; për të përgjithshmen *trokas* në këto zona të Shqipërisë Qendrore përdoret *kris* (psh. *krisi porta*). Po kështu ndodh edhe me sllavizma të tjera të gjuhës letrare si: *çetë*, *gërmadhë*, *kastravec*, *krap*, *padis*, *trondis* etj.

Ndonjëherë sllavizmat nuk kanë një përdorim të përgjithshëm, por ekzistojnë vetëm në disa shprehje të caktuara, p.sh. në Malësinë e Tiranës fjala *çast* nuk përdoret veçse në shprehjen *orë e çast*, *çetë* përdoret me kuptimin “ndarje, klan” në shprehjen *janë bā çeta-çeta*, *vadë* në shprehjen *e ka bā vadë* “e ka bërë rrugë”, *bgat* ekziston vetëm në kuptimin e foljes, në shprehje si: *nuk m’ka bgatë* “nuk më ka bërë ndonjë nder të madh” etj.³ Në Valbonë fjala *paçamur* “papare, qull”, si fjalë e gegërishtes veriperëndimore, dëgjohet vetëm në shprehjen *e bane paçamur* “e bëre lëmsh (punën)”; në Dajç fjala *tërnaqop* “kazmë” përdoret më fort me kuptimin “punët e rënda të bujqësisë”, në shprehje si *na mbyti tërnagopi*; fjala *plloçë* në Barbullush përdoret me kuptimin “qëndisje në formë njolle”; fjala *ganec* “prijës shtrigash” në Gjadër ka kuptimin “njeri i shkathët”; në Shupal fjala *bërlluk* “kashtë e imët që mbetet pas të shirit” përdoret më fort në shprehje si *âsht bā bërlluk* “është bërë pleh, copë e thërrime”; ose fjala *zhabë* që gjetiu në Veri ka kuptimin “lëkurë e regjur dhie”, aty përdoret me kuptim të figurshëm *e ka fytyrën si zhabë*; në Valbonë fjala *gërlac* “gabzherr”, më fort e gegërishtes veriperëndimore, njihet, por përdoret vetëm me kuptim të ngjyruar (pejorativ-tallës) etj. Pra këto fjalë në këto zona përdoren jo në kuptimin e tyre të mirëfilltë, por në një kuptim të

³ Të dhënat për Malësinë e Tiranës janë marrë nga prof. Seit Mansaku, me origjinë nga Shupali i Dajtit.

bartur, gjë që tregon se nuk janë vendase por kanë ardhur si ndikim nga krahina të tjera më të skajshme.

Shtegtime fjalësh mund të konstatohen edhe në raste kur një fjalë i përket një zone të caktuar për nga kushtet e terrenit, por haset edhe në zona të tjera më të largëta. Kështu p.sh. fjala *drobe* “shpend i madh liqenesh e kënetash” në Malësi të Madhe apo në Pukë duhet të ketë ardhur nga zona liqenore si Gropa e Shkodrës; *krap* është gjithashtu fjalë e zonës rreth liqenit të Shkodrës, por që është përhapur edhe në zona të tjera, madje ka hyrë edhe në gjuhën letrare; *mrezhë* është një lloj rrjete që përdoret nga peshkatarët në Shëngjin e në Shkodër, por njihet edhe në Gjadër. Në bazë të njohurive historike e folkloristike dihet se fjala *kreshnik* i përket në origjinë një zone kufitare të gegërishtes veriore, por më vonë është përgjithësuar e ka hyrë edhe në gjuhën letrare. Fjalë të tilla si: *bisedë*, *gëmushë*, *krahinë*, *rend* etj. që kanë qenë në thelb fjalë krahinore të gegërishtes veriore (Çabej, Jokl), sot janë të mbarë gjuhës e të gjuhës letrare.

Duke shtegtuar nga një zonë në tjetrën, fjalët kanë pësuar edhe ndryshime në formë e në kuptime.⁴

Format dhe kuptimet e fjalëve ruhen më mirë në zonat periferike kufitare në kontakt me të folmet serbe prej të cilave janë huazuar fjalët. P.sh. në Çerem të Tropojës fjala *kyç* e Valbonës dhe e Jugut del me formën fonetike *kjuç*, që ka pësuar më pak ndryshime fonetike në raport me origjinalin serbokroat *ključ*, pra vetëm ndërrimin *lj > j*. Në Valbonë fjala *kreshnik* e mbarë gjuhës del në trajtat *krashnik* e *krazhnik* që janë më pranë skr. *krajišnik*, *kraešnik*. Trajtat *i udobë*, *i uadoptë* në Shestan, Kelmend e Pukë ruajnë më mirë trajtën e origjinalit skr. *udob* sesa fjala e mbarë gjuhës *i dobët*; trajta *gërmushë* e Hotit, Bajzës,

⁴ Kështu fjala *gëmushë* në Malësi të Madhe, Bajzë e Dukagjin del *gërmushë*, ndërsa në Mirditë *gjëmushkë*, me ndërrimin karakteristik *g > gj* të kësaj krahine; fjala *gozhup* në Dajç shqiptohet *gozhun*, në Gash *gozhuf*, në Shkrel *kozhup* e *kozhun*; fjala *jarm* “zgjedhë” në Çerem dëgjohet *arëm*, fjala *llukë* del edhe në format *kjukë*, *klлуq* dhe *llukë*; fjala *mrraulë* në Malësi të Madhe shfaqet edhe si *mrragël* e *mrravël*, në Dajç e në Mërtur të Gurit *mrrrelë* e në Shkrel *mrraçë*; fjala *memec* del edhe *nemec* (Valbonë, Mërtur i Gurit) e *manec* (Shupal); *paskajë* del edhe në format *paskaq*, *paskall* e *biskaq*; *rok* “afat” në Valbonë e Mërtur të Gurit shqiptohet *orok*; *sqotë* del edhe me trajtat *skllotë* e *sllotë* etj.

Po kështu nga një krahinë në tjetrën vihen re edhe ndryshime e zhvillime kuptimore. P.sh. *gozhup* në Mirditë ka kuptimin “fletët që mbulojnë kallirin e misrit”; *strokë* “sëmundje e bagëtisë; zgjebe” në Mirditë ka kuptimin “lesh i gjatë që i lihet dashit të kumborës”; *resit* “fshij, shlyej” në Gjadër del me kuptimin “mbaroj, zgjidh, kryej”, që është edhe më afër kuptimit të serbokroatishtes *rešiti* “zgjidh”; *ograjë* del me kuptime të ndryshme në zona të ndryshme: “pyll i vogël me kullotë”, “livadh malor”, “vathë berrash për të shtënë bagëtinë të kullosë”; “tokë e rrethuar me gardh”, “kopsht pranë shtëpisë” e kështu me radhë.

Dukagjinit është më afër skr. *grmuša* sesa *gëmushë* e zonave më jugore. Nga trajtat e ndryshme me të cilat del leksema *mrraulë* “mizë dheu”, më pranë origjinalit skr. *mrvav* është *mrvavël* e Hotit. Nga variantet e ndryshme fonetike të leksemës së huazuar *sqotë* (*shqotë*, *skllotë*, *sllotë*) trajta *sllotë* e Çeremit është e njëjtë me skr. *slota*. Trajta *nemec* e Valbonës dhe e Mërturit të Gurit nuk ka pësuar ndryshime fonetike në raport me origjinalin skr. *nemec*, ndërsa *memec* e mbarë gjuhës a *manec* e Shupalit kanë pësuar asimilim regresiv apo metatezë. Në Çerem ruhet varianti *zupc* “bizë”, më pranë burimit serb. *zubac* (rrënja *zubb-*) kundrejt varianteve të tjera *zumc* (Luzni-Dibër), *zumç* (Hot) që kanë pësuar ndryshime fonetike ($b > mb > m$), e kështu me radhë.

Po kështu përmbajtja semantike e fjalëve me burim sllav në zonat periferike ruhet më mirë në raport me kuptimet e fjalëve burimore sllave. Nga kuptimet e ndryshme që ka leksema *ograjë*: “pyll i vogël me kullotë”, “livadh malor”, “vathë berrash për të shtënë bagëtinë në kullotë”, “tokë e rrethuar me gardh”, kuptimi i fundit, që del në Valbonë e në Shkrel, i afrohet më shumë atij të origjinalit skr. *ograda* “vend i rrethuar”; fjala *vrellë* “vorbull, gjeratore” në Valbonë del me kuptimin “burim”, i cili është i njëjtë me atë të skr. *vrelo* “burim”. Nga disa kuptime që ka leksema *voz*, si “përrua i vogël me pak ujë dhe me bar anash” (Shkodër, FGS, FGJSSH), “grumbull bari i porsakositur” (Valbonë-Tropojë, Nikaj-Mërtur), “shkop i gjatë që shërben për transportin e grumbullit të barit” (Bujan-Tropojë), ky i fundit është më pranë burimit të fjalës: serb. *voz* me kuptimin “ngarkesë” pra “aq sa mund të mbartet me një ngarkesë” (Svane 42). Në Shkrel dëshmohet *vrujë* “burim”, një rrënjë që përndryshe del në folje të prejardhura si *vrujon*, *vrijon* ose në rrjedhoja emërore si *vrujinë*, *vruin*, *vruit*, *vrujim*. *Vrujë* e malësisë së Veriut vjen drejtpërdrejt nga serb. *vrujla* me të njëjtin kuptim.

Një numër sllavizmash që janë përgjithësisht të Jugut e si rrjedhim janë përcaktuar me burim prej bullgarishtes, i ndeshim edhe në ndonjë pikë në Veri. Në Valbonë dalin fjalë që nuk i kemi hasur gjetkë në Veri: *brazë* “brazdë” (edhe në Dukagjin), *policë*, *rreckë*, *sajë*, *stap*, *shuk*, *tulatem*, *troshitem*, *ulicë*, *vedër*, *venitet*, *vërsnik*, *vërvit*. Në pika të tjera gjejmë edhe sllavizma të tjerë që përndryshe dalin në Jug, si p.sh.: *mushicë* në Shkodër, *moçal* në Malësi të Madhe, *kitë* “hej akulli” në Malësi të Madhe (në Jug *okitë* “brymë në gjethet e pemëve”), *kyç* në Valbonë (edhe në Çerem *kjuç*), *mornica* (Malësi e Madhe, Valbonë), *përzhis* (Valbonë, Mërtur i Gurit), *selishtë* (Malësi e Madhe), *velencë* (Mërtur i Gurit, Kukës, Peshkopi) etj. Fjala *livadh* me burim nga greqishtja, në Çerem del në trajtën *livadë*, e cila flet për huazim nga serbishtja *livada* (Svane 167). Në këto raste, për sa u përket pikave verilindore të territorit të shqipes, do të pranojmë burimin e tyre prej të folmeve dialektore serbe të zonave në kontakt me të folmet maqedonase. Siç ka rezultuar nga studimet e Selishçevit, në të folmet sllave të krahinës rreth Prizrenit takoheshin elemente të dy zonave

gjuhësore sllave: serbe dhe bullgaro-maqedonase, ndërsa toponomastika sllave në veri dhe veriperëndim të Prizrenit paraqiste elemente të së folmes bullgare⁵. Të dhënat gjuhësore të vëna në dukje prej tij mbështeteshin edhe nga vëzhgimet etnografike të A. Haberlandt për krahinën rreth Prizrenit, i cili arrinte në përfundimin se, ndryshe nga popullsia në drejtimin Mitrovicë-Pejë që në pjesën më të madhe përbëhet nga banorë më të rinj, me origjinë serbe, popullsia në Metohinë e Jugut i përket një grupi sllav me tipare më të vjetra më afër maqedonasve e, indirekt, bullgarëve.⁶ Këto përfundime mund të përforcohen edhe nga studimi i sllavizmave të shqipes. Sllavizmat e shqipes verilindore, pra jo vetëm ato të gegërishtes lindore të Peshkopisë, por edhe të zonës së Kukësit e të Lumës dhe më në veri, pjesërisht mbartin tipare të sllavishtes ballkanike lindore, pra të maqedonishtes, përkatësisht bullgarishtes.

Nga kërkimet në terren në krahinat jugore të Shqipërisë prej Xh. Yllit rezulton se numri më i madh i leksemave me burim sllav gjendet në zonën juglindore, në pikat skajore të hapësirës shqipfolëse në kontakt të drejtpërdrejtë me popullsitë sllave fqinje, siç është fshati Miras në Devoll, me një numër prej rreth 350 njësisish leksikore me burim sllav, fshati Tren i Fushës së Korçës me po aq njësi leksikore, fshati Buçimas (Starovë) në Pogradec me 300 sllavizma, fshati Trebinjë në Mokër me rreth 300 sllavizma, ndërsa në pikat që vijnë duke u larguar nga këto zona skajore, si në veri, jug e perëndim, numri i sllavizmave vjen duke u pakësuar. Psh. në Dragostunjë të Librazhdit njehsohen rreth 200 sllavizma, në Shushicë të Elbasanit rreth 200, në Çarshovë të Përmetit po aq, dhe një rezultat të tillë e konfirmojnë edhe hulumtimet në pika të tjera si Dëshnicë e Dangëlli të Përmetit, në Vlorë, Myzeqe, Darsi etj. me një numër më të pakët leksemash me burim sllav.⁷

Inventarin më të plotë të huazimeve sllave në gjuhën shqipe e ka dhënë sllavisti danez Gunnar Svane, me një numër të përgjithshëm prej rreth 1000 sllavizmash, që duket një shifër e konsiderueshme.⁸ Por hetimi i përhapjes gjeografike të sllavizmave jep një pamje më realiste të peshës specifike të ndikimit sllav në shqipe, duke njehsuar një numër maksimal prej rreth 350 sllavizmash në pikat periferike më pranë ndikimit sllav në Shqipërinë juglindore, përkatësisht 280 sllavizmash në pikën skajore verilindore të Shqipërisë veriore (Valbonë).

⁵ A. M. Selishçev, *Slavjanskoe naseleenie v Albanii*, vep. cit. f. 4; Po ai, *Polog i ego bolgarskoe naselenie*, Sofia, 1929, f. 411-416.

⁶ A. Haberlandt, *Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien*, Wien, 1917, f. 157; A. M. Selishçev, *Slav. nas.*, f. 4.

⁷ Xh. Ylli, "Mbi disa huazime leksikore sllave në të folmet juglindore të shqipes", art. i cit., f. 146.

⁸ G. Svane, *Slavische Lehnwörter im Albanischen*, Acta Jutlandica LXVIII, Humanistische Reihe 67, Aarhus University Press, 1992.

Me gjithë karakterin përgjithësisht lokal, një numër i rëndësishëm sllavizmash është bërë pjesë e fondit të gjuhës së përbashkët dhe ka hyrë edhe në gjuhën standarde. Rrugët e hyrjes së tyre në gjuhën standarde janë të ndryshme. Një pjesë syresh, pas gjase të hyra që në periudhat e para të kontakteve të sllavëve me shqiptarët, në fazën më unitare të shqipes, kur dy dialektet ishim shumë më pranë njëri-tjetrit se ç'janë sot, u bënë fjalë të mbarë gjuhës e pastaj të gjuhës letrare. Disa të tjera, në zanafillë me përkatësi krahinore, me mënyra të ndryshme, nëpërmjet bashkëveprimit ndër-dialektor, por kryesisht nëpërmjet letërsisë, u bënë pronë e gjuhës letrare dhe u përgjithësuan edhe në gjuhë.

G. Svane ka kryer një vjelje shteruese të të gjithë sllavizmave të përfaqësuar në fjalorët e shqipes së sotme, nga e cila kanë rezultuar një numër prej 382 emrash dhe 82 foljesh në FGS (1954) e FGJSSH (1980), dhe 72 folje në FSSH (1984).⁹ Kjo diferencë shpjegohet pas gjase me faktin se disa nga fjalët ende të përfaqësuar në Fjalorin e 1980-s ndërkaq janë ndër si të vjetruara ose dialektore për gjuhën e sotme standarde.

Për shkak të karakterit më fort bujqësor e të lidhur me natyrën të sllavizmave të shqipes, është e natyrshme që, me urbanizimin dhe modernizimin në rritje të shoqërisë shqiptare, një numër sllavizmash që më parë mund të konsideroheshin të mbarë gjuhës, pra përgjithësisht të kuptueshëm nga të gjithë, erdhën duke dalë nga përdorimi në një shoqëri qytetare. Kjo dukuri është pasqyruar edhe në fjalorët e shqipes së sotme. Siç ka dalë nga kërkimet e Svanes, një numër prej 129 sllavizmash (112 emra dhe 17 folje) të përfaqësuar në FGS (1954), janë mënjanuar nga fjalorët më të rinj të 1980-s e të 1984-s. Një arsye tjetër e reduktimit progresiv të sllavizmave në fjalorët modernë të shqipes janë edhe prirjet për pastërtinë e gjuhës shqipe të zbatuara nga gjuhësia shqiptare sidomos para '90-s.

Ne kemi përpiluar një listë, jo përfundimtare, të sllavizmave që i konsiderojmë si fjalë të gjuhës standarde. Si kriter për këtë nuk duhet të shërbejë patjetër prania e lemave në fjalorët e gjuhës së sotme shqipe, të cilët përfshijnë edhe shumë leksema me përdorim të ngushtë,¹⁰ por shkalla e integritimit gjuhësor dhe kulturor të tyre në gjuhën shqipe në bazë të përdorimit të tyre në shqipen e shkruar dhe të ndjesisë vetjake gjuhësore për pranueshmërinë e tyre në standardin e shqipes. Për këtë arsye kemi përjashtuar nga kjo listë jo vetëm fjalë që janë të të dy dialekteve por që nuk janë përfshirë në FGJSSH, si *pokrovë*, *razbit*, por edhe të tilla që pas mendimit tonë nuk janë

⁹ G. Svane, vep. cit., f. 279-281.

¹⁰ Për arsyet e përfshirjes në Fjalorin e 1980-s të fjalëve me përdorim të ngushtë a tepër të ngushtë shih A. Kostallari, "Parimet themelore për hartimin e 'Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe', në: *Studime mbi leksikon*, II, f. 23, 62, 68.

pasuri e gjuhës standarde në gjendjen e sotme, si *avitem, crule/cule, rizë, mesnik* e ndonjë tjetër.

Për të dhënë një pamje më të qartë edhe të përmbajtjes konceptuale të sllavizmave, sllavizmat e gjuhës standarde i kemi dhënë të ndara sipas fushave semantike ku bëjnë pjesë:

- 1) Emërtime të pjesëve të trupit: *grusht, këllk,¹¹ kockë, qepallë, sisë, trup*.
- 2) Emërtime të sferës familjare e farefisnore: *bacë, teto*.
- 3) Emërtime të fushës së bujqësisë: *brazdë, dordolec, hosten, kopicë, koçak, kosë, kosh, kotec, krasit, lehe, lesë, pleh, plug, prashis, sanë, selishtë, stavë, tog, ugar, vadit, vlagë*.
- 4) Emërtime të blegtorisë: *grazhd, kërmë, oqiç, rudë, stan*.
- 5) Emra bimësh e kafshësh: *borigë, borzilok, gëmushë, galë, gorricë, kastravec, karkalec, kopër, koran, kotele, krap, krifë, kuçkë, labot, lis, luspë, mace, maçok, molë, pelin, sokol, shapkë, vishnjë, zhabë*.
- 6) Emërtime të jetës shtëpiake e të fshatit; enët, ushqimi: *dërstilë, gëlltit, gërmadhë, gostit, kade, jaz, kllaçkë, kore, kolibe, koritë, koshere, kovë, kulaç, leskër, oborr, orendi, përzhis, plloçë, pelenë, pogaçe, purtekë, prag, rrogoz, sitë, stol, strehë, vedër, velenxë*.
- 7) Veshmbathja: *opingë, shuk*.
- 8) Sëmundje, difekte: *çfilit, i dobët, drobit, kapit, kllapi, memec, mornica, ngërç*.
- 9) Emërtime të sferës së zanateve; instrumente të ndryshme, armë: *bravë, godis, gozhdë, kalit, kleçkë, kopaçe, kordhë, konop, kovaç, kyç, lopatë, patkua, pushkë, serë* (Meyer: sll. vj. k.), *spicë, strug/zdrukth, verigë, tërkuzë, trap, xehe*.
- 10) Mjedis i jashtëm (terreni, ujërat): *breg, çurkë, golle, lëndinë, llom, moçal, rrëke, rrafsh, zabel*.
- 11) Koha, dukuritë atmosferike: *çast, duhi, duf, sqotë, vetëtin, zagushi, zheg*.
- 12) Jeta shoqërore: *bisedë, i begatë, bujar, dobi, grabit, hua, kob, kurvë, lakmi, llomotit, nevojë, orvatem, pijanec, plaçkë, porosis, potere, pusulle, sodit, shetit, tutkun, i vobegë, vërsnik, zbavit*.
- 13) Jeta politike, administrata: *gjobë, kasnec, krahinë, kreshnik, padis, rend, rob, sundoj, zakon*.
- 14) Sfera emocionale, bestytnitë: *dihat, habitem, lebetitem, lubi, lugat, mahnitem, mërzit, nemitem, neverit, tronditem, tulates, vigan*.
- 15) Folje e ndajfolje të ndryshme: *buhavit, buçet, dremit, gumëzhin, hallakat, mbufat, nuhat, piskas, posaçëm* (nga *posaçë*), *sokëllij, spërkat* (nga *përskat*), *topit, trokas, troshit, tulates, venit, vërtit, vërvit, vikat, volit, vozit, vazhdë*.

¹¹ Fjalë e toskërishtes e etimologjizuar si sllave nga Svane 178.

Nga një vështrim i kësaj paraqitjeje të diferencuar të sllavizmave të gjuhës së sotme letrare, vihet re se numrin më të madh e përbëjnë huazimet e fushës së bujqësisë e të jetës fshatare në përgjithësi. Edhe ky fakt flet për karakterin kryesisht fshatar të sllavizmave të shqipes. Nga pikëpamja sociale mund të nxirren përfundime edhe për bashkëjetesën midis sllavëve e shqiptarëve më fort në zonat rurale.

Një pjesë e leksemave me burim sllav që janë përgjithësuar në gjuhë ose janë bërë pjesë e standardit letrar të shqipes, në zanafillë kanë qenë të një dialekti të caktuar. Kështu emra si *bisedë*, *krahinë*, *nevojë*, *rend*, *bujar* në origjinë kanë qenë fjalë të gegërishtes veriore, që janë përgjithësuar në gjuhë përmes letërsisë dhe tashmë janë pronë e gjuhës standarde. Folje si *buçet*, *çudit*, *topit*, *orvatem* janë përgjithësuar mjaft herët në mbarë gjuhën, por vatra e përhapjes së tyre është gegërishtja veriore; *drobot* ka qenë në zanafillë fjalë dialektore e toskërishtes; *kockë*, *koskë* është formë dialektore e toskërishtes lindore (forma më e afërt me burimin e huazimit është *koc* e gegërishtes) e përgjithësuar nëpërmjet gjuhës letrare; *orendi* është fjalë e toskërishtes lindore e përgjithësuar në gjuhë¹².

Për një numër të tyre na vjen në ndihmë studimi i gjuhës së teksteve të vjetra shqipe. Përmes tyre ne mund të fitojmë dëshmitë më të hershme shkrimore të hyrjes së sllavizmave të caktuara në shqipen. Duke i krahasuar këto sllavizma me gjendjen e shpërndarjes së tyre dialektore në territorin e shqipes, mund të përcaktojmë pak a shumë saktë zanafillën dialektore të përhapjes së një sllavizmi në dialektet e tjera. Në këtë mënyrë mund të saktësojmë zanafillën gege të disa sllavizmave që sot kanë përhapje të gjerë në territorin e shqipes dhe janë pronë e gjuhës letrare, si: *avit*, *bashtinë*, *bisedë*, *i begatë*, *çudit*, *habit*, *leçit*, *oborr*, *rend* “radhë, rresht; rregull”, *sanë* “kashtë”, *sodit* “vështroj, kundroj”, *sundoj*, *shetit* etj.

Bisedë dëshmohet gjerësisht në gegërishten veriore dhe në tekstet e vjetra (përveç Bogdanit, i cili përdor leksemat më të vjetra *kuvend*, *kuvenduem*), po ashtu edhe në Shqipërinë juglindore, ndërsa në Shqipërinë e Mesme e të Jugut njihet më fort nëpërmjet gjuhës letrare. *Bashtinë* është po ashtu një fjalë e geg. veriore që shtrihet deri në Malësinë e Tiranës (*bështinë*), ku ka marrë kuptimin “tufë bagëtish që kullosin pa bari”. Dëshmohet edhe për tosk. e Korçës e të Pogradecit si “prona e babait të gruas”, në një shprehje me kuptim të bartur “dhëndër brenda, kollovat” (KLSH). Leksema *i begatë* sot është e përhapur në mbarë gjuhën, por nga të dhënat dialektore të terrenit, të fjalorëve (Kristoforidhi e jep si gege) dhe të teksteve të vjetra të Veriut duket të ketë

¹² Shih për këto fjalë E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I-VII, nën zërat përkatës; khs. edhe përhapjen gjeografike të leksemave te Xh. Ylli, *Das slavische Lehngut im Albanischen*, München, 1997, në hartat përkatëse.

qenë në zanafillë e gegërishtes. *Çudit*, me rrjedhjen *çudi*, sipas Çabejt, është përhapur në mbarë gjuhën me pikënisje gegërishten veriore; nga autorët e vjetër dëshmohet te Buzuku. *Habitunë* del së pari te fjalori i Da Lecces (1702) “gaboj në llogari” dhe fjalorët e shënojnë si gege (Miklosichi, Kristoforidhi, Meyeri, Bashkimi). Sot përdoret në mbarë territorin e shqipes. Në Veri del më fort kuptimi “hutoj”, në Jug “çudit”. *Leçis* “shpall, publikoj; nxjerr jashtë bashkësisë” është fjalë e autorëve të vjetër me përhapje në geg. veriperëndimore si Malësi e Madhe, Fushë-Zadrimë, Mirditë me kuptimin “shpall; nxjerr në tellall për të shitur”, që jepet edhe për tosk. lindore të Korçës “lexoj; predikoj”. *Oborr* është më fort e gegërishtes, del në tekste e vjetra (përveç Bogdanit që përdor latinizmin *kurt*), por e ka dhe toskërishtja lindore. *Sanë* (te Buzuku, Bardhi, Bogdani) është në thelb fjalë e gegërishtes që ka hyrë edhe në gjuhën letrare. *Sodit* “vështroj, kundroj”, është fjalë në zanafillë e Veriut, sot e përhapur në mbarë gjuhën. Edhe *sundoj*, sot e mbarë gjuhës, duhet të jetë formuar brenda shqipes nga *sund* që dëshmohet që në Kuvendin e Arbënit (1706): CuA 25 29: Mund jetë se të pyetë kush ç’i s’ka pushtenë, ndo tjetërin *sund* (Potest quidem à privatâ Personâ, quae omni caret auctoritate), si dhe në tekste të geg. veriore me kuptimet “vendim me fuqi ligjore; ligj, rend; mbikëqyrje, sundim, mbrojtje” (KLSH), nga sll. e vj. *sođь* “gjyq”. Një tjetër sllavizëm pas gjase me zanafillë gege dhe sot i mbarë gjuhës është *shëtiti*, te Buzuku *shetat*, meqenëse kuptimi më i afërt me atë të shqipes gjendet në serbishten *šetati* (*se*), pra është një ndikim që vjen nga Veriu. Në shumë të folme toske nga kërkimet në terren dëshmohet si fjalë e re (Ylli 256).

Pjesa më e madhe e këtyre leksemave përdoren edhe sot në mbarë gjuhën dhe në gjuhën standarde me të njëjtat kuptime. Ato janë bërë prodhimtare brenda shqipes duke formuar çerdhe leksikore. Disa të tjera kanë pësuar ndryshime kuptimore në rrjedhë të kohës. *Porosit*, në shqipen e vjetër “ia lë dikujt në dorë, raccomandare”, nga sll. **po-ročiti* “dorëzoj, ia lë në dorë dikujt; porosis” që lidhet me **rōka* “dorë” (Jokl 1911: 114), (khs. serb. *poručiti* “porosis, i çoj fjalë”, bullg. *porъčvam* “urdhëroj”), sot ka kuptimet “i bëj një kërkesë; i ngarkoj një detyrë, urdhëroj”. *Mërzit* te autorët e vjetër del edhe me kuptimin “urrej”, psh. Budi DC 200 21: Praashtu si e *mërzite*, atë mkahtë mallëkuom, më afër burimit sllav (khs. serb. *mъziti*, bullg. *mъzi me*, sll. e vj. kishtare *mъzěti* “urrej”), ndërsa sot ka kuptimin “bezdis, shqetësoj”. *Neverit* “lë pas dore, braktis, abandonare” (Bardhi 2 4), te Bogdani del me kuptimin e herezisë në mbiemrin prejpesor të *neveritunë* “heretici”: e kështu janë mirëfilli të *neveritunë* ligjet së Mojsëut e së Mesisë (I 80 6) “e così sono veri heretici della legge di Moisé...”, dhe emrin asnjans të *neveritunitë* “heresia”: Përse të *neveritunitë* nukë është tjetër veçë një të dam o të larguem së Shkruemit Shëjt “Percioche l’heresia non è altro, che una derivatione (= deviatione), e allontanamento dalla Sacra Scrittura” (I 80 6), më afër kuptimit të fjalës sllave: serb. *nëveran* “i pabesë; i pafe”, *iznëveriti* “tradhtoj; bëhem i pabesë”. *Pogaçe*

në shqipen e vjetër përdorej më fort si “bukë e ndorme; pane azzimo”, khs. Bogdani I 64 6: e atë natë t i hanjinë mishtë tinaj me bukë *pogaçe* e loqikë të tharëtë o t'idthuna “e che in quella notte mangiassero le sue carni con *pane azimo*, e latuche agreste, ò amare”, nga serb. /bullg. (maq.) *pogača* “kulaç i sheshtë, pa tharm”, sot nëpër dialekte me kuptime të ndryshme, më fort “kulaç, focaccia”. *Leçitunë* te Bardhi e Bogdani “publikoj, shpall”, khs. Bogdani: e nfshefunë *ka me u leçitunë*, e ka me kjanë dukunë gjithë shekullit ngushëllimi Tinëzot (I 122 15) “si propalarà, e sarà nota...”, sot në të folme të geg. veriore “nxjerr në tellall për të shitur”, te arbëreshët e Italisë dhe në Jug edhe “lexoj”. *Pehar*, te Bardhi e Bogdani “kupë”, nga skr. *pèhār* “gotë, kupë” (prej gjerm. *Becher*), në të folme veriore të sotme del me kuptimin “garuzhdë”. Leksema *stan* në fillim ka pasur me sa duket kuptimin “banesë” të sllavishtes së vjetër, pasi përdoret me këtë vështrim te Buzuku e te Budi: khs. Buzuku 26r8: paqi i Tinëzot kloftë mbī këtë *stan* e atyne, qi mbrenda jesënë; Budi SC 383 29: mbas mortje të vinjë me j kallëzuom, se pa ku kā për jetët me j qenë vendi e *stani* i shpīrtit. Në fjalorin e Da Lecces del së pari kuptimi i sotëm “kasolle barinjsh”: *stān* “tëbān, stazzo de pecorari” (241r), *stāni i çobanëvet* “stazzo de pecorari” (241r).

Këto hulumtime tregojnë se elementi sllav i shqipes nuk duhet vështruar në mënyrë të padiferencuar, por në bazë të peshës së tij specifike në leksikon e shqipes, duke përcaktuar vendin që zë ky element në përdorimin e përgjithshëm të gjuhës dhe duke dalluar elementet me përdorim krejt të ngushtë lokal.

SUMMARY

THE REGIONAL SPREAD OF ALBANIAN SLAVISMS AND THEIR PLACE IN THE STANDARD ALBANIAN LEXICON

The Slavic elements of Albanian reflect, among other things, the way the Slavs settled in the Albanian-speaking territories. Field research of Slavic borrowings shows that their geographical spread has a regional character, thus coinciding with the areas of more intensive contacts of Slavic and Albanian populations. These are generally the border areas of the Albanian territory, in which we find a relatively large number of Slavisms, while in the interior areas Slavisms are rarer. Additionally, it is important to note here that the lexical meaning of Albanian Slavisms indicates that this corpus is mostly connected to aspects of rural life in the villages across the border areas. Despite their local and rural character, a significant number of Slavisms have become part of the fund of the common language and the standard Albanian language. Some of these lexemes that have been generalized in the language were originally of a

specific dialect. The study of the language of old Gheg Albanian texts helps us to obtain the earliest written evidence of the entry of certain Slavisms into Albanian. By comparing these Slavisms with the state of their dialectal distribution in the territory of Albanian, we can determine the dialectal origin of the spread of a Slavism in other dialects. In this way we can specify the northern Gheg origin of some Slavisms that today are widespread in the territory of Albanian and are part of the standard language. The paper analyses a corpus of several different words of the standard language whose presence in old Albanian texts (XVI-XVII centuries) indicate that they originally belonged to the north Gheg dialect, showing thus the path of the spread of Slavisms in the literary written language up to the standard Albanian language .

These results show that the Slavic element of Albanian should not be viewed as being undifferentiated, but based on its specific weight in the Albanian lexicon, with some of it having penetrated in the general use of the language and some being limited in restricted local use.

BIBLIOGRAFI

Burimet:

- Çabej, E., Meshari i Gjon Buzukut, botim kritik, Tiranë, 1968
- Demiraj, B. Dictionarium Latino-Epiroticum (Romae 1635) per R. D. Franciscum Blanchum, Botime Françeskane, Shkodër, 2008
- Gurga, G. (ed.), Francesco Maria Da Lecce, Dittionario italiano-albanese (1702), botim kritik, Botime Françeskane, Shkodër, 2009
- Kartoteka e Leksikut të Shqipës pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë (=KLSH)
- Omari, A. (ed.), Pjetër Bogdani, Cuneus Prophetarum, botim kritik, Tiranë, 2005
- Svane G. (ed.), Peter Budi, Rituale Romanum (1621). With a transcription into modern ortography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986.
- Svane, G. (ed.), Peter Budi, Dottrina Christiana (1618). With a transcription into modern ortography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1985.
- Svane, G. (ed.), Peter Budi, Speculum Confessionis (1621), With a transcription into modern ortography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986

Literaturë e cituar:

- Çabej, E., *Studime etimologjike në fushë të shqipës*, vëll. II, A-B (Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, IGJL, Tiranë, 1976); III, C-D (ASHSH,

- IGJL, Tiranë, 1987); IV, DH-J (ASHSH, IGJL, Tiranë, 1996); VI, N-RR (ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002); VII, S-ZH (ASHSH, IGJL, Tiranë, 2006); V, K-M (Bot. Çabej, Tiranë 2014) (=SE)
- Haberlandt, A., *Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien*, Wien, 1917.
- Jokl, N., *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortforschung*. In: Sitzungsber. d. Kais. Akad. d. Wiss. in Wien. Phil.-Hist. Kl., Bd. 168, Abhandl. 1. Wien, 1911.
- Kostallari, A., “Parimet themelore për hartimin e ‘Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe’”, në: *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë, 1972.
- Omari, A., *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, QSA, IGJL, Botimet albanologjike, Tiranë, 2012.
- Seliščev, A. M., *Polog i ego bolgarskoe naselenie*, Sofia, 1929
- Seliščev, A. M., *Slavjanskoe naseleenie v Albanii*, Sofia, 1930.
- Svane, G., *Slavische Lehnwörter im Albanischen*, Acta Jutlandica LXVIII, Humanistische Reihe 67, Aarhus University Press, 1992
- Ylli, Xh., “Mbi disa huazime leksikore sllave në të folmet juglindore të shqipes”, *Studime filologjike*, 1988/2, f. 145-152.
- Ylli, Xh., *Das slavische Lehngut im Albanischen*, 1. Teil Lehnwörter, Slavistische Beiträge 350, Otto Sagner, München, 1997.

